

1842



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
 Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik
 "Koço Gliozheni"

Adresa: Bul. "Bajram Curri", tek Brryli, Nr.1001 Tiranë. Tel:+355 42267797
 Email: KocoGliozheni@shendetesia.gov.al

Nr. 768/1 Prot

Tiranë, më 26.08 2021

Drejtuar: Qendrës "Res Publica"
 Z. Dorian Matlija

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ardhur në Institucionin tonë më datë 29.07.2021, me Nr. 83/21 Prot, ju informojmë si vijon:

Në spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik 'Koço Gliozheni' është përcaktuar, një ambient i dedikuar sipas të gjithë parametrave për trajtimin e grave shtatzëna të prekura nga COVID19, janë trajtuar 127 pacientë të prekur nga COVID19, prej të cilave 86 janë paciente lehonat dhe 41 janë pacientë neonat.

Numri pacientëve COVID të trajtuar në terapi intensive për 2020-2021 është 1 paciente e intubuar. Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik 'Koço Gliozheni' ka infrastrukturën e duhur për trajtimin e pacientëve me COVID, nga ekzaminimet deri tek trajtimi me medikamente sipas protokolleve përkatëse.

Në Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik 'Koço Gliozheni' nga 2019-2021 janë kryer me sukses 5609 ndërhyrje kirurgjikale falë punës profesionale të stafëve mjekësorë dhe aparaturave të teknologjisë së lartë. Në maternitetin "Koço Gliozheni", ka nisur investimi 1 milion dollarë, për rehabilitimin e plotë të urgjencës, qendrës së gruas, rikonstuksionin e sallave të operacionit dhe shtimin e kapaciteteve të tyre me dy salla të reja operacioni, pajisjen e tyre me aparaturë të teknologjisë së fundit për të ngritur në një nivel më të lartë shërbimin për nënën dhe fëmijën. Për furnizimin e oksigjenit medical spitali ynë ka lidhur kontrat të cilën e gjeni të publikuar në APP.

Faleminderit për bashkëpunimin!





MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni" Tirane

Adresas: Bulevardi "Bajram Curri", Tiranë, Shqipëri

Nr. 971/1 Prot

Tiranë, më 28 9 /2021

Lënda: Kthim Përgjigje

Drejtuar: Qendra "Res Publika"

Për dijeni: Komisionerit për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes Së të dhënave Personale

Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor

Në përgjigje të shkresës së ardhur nga Komisioneri Për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me Nr.1492/1 Prot, datë 14.09.2021 e protokolluar nga ana jonë me Nr.929 Prot. datë 16.09.2021 si dhe nga OSHKSH me Nr.2510/1 Prot. datë 20.09.2021 protokolluar nga ana jonë me Nr.971prot datë 24.09.2021 " Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare", ju informojmë si më poshtë:

Personit juridik "Qendra Res Publica" i është kthyer përgjigje nga Institucioni ynë me shkresën Nr.768/1 prot. datë 06.08.2021.

Me date 17.09.2021 Qendra "Res Publika" ka dërguar e-mail zyrtar pranë S.U.O.GJ "Koço Gliozheni" Tiranë, ku shprehet se do një informacion më të detajuar për sa i përket pikës 4 dhe pikës 5 të kërkesës Nr.83/21,(Bashkëngjitur shkresës).

- A. Në lidhje me kopjen e dokumentave për sa i përket procedurës së tenderit të zhvilluar nga M.S.M.Sh, kemi vendosur web - linkun e buletinit te APP-së , i cili ka të publikuar dokumentet:
- Njoftimin e kontratës
 - Dokumentat Standarte të Tenderit.

Linku:

Objekti i tenderit: B1-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, Anestezi -Reanimacion, Antituberkulare, Antineoplastike dhe immunomodulatore, antiparazitare, dermatologjike, hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese të gjakut dhe Sistemi Respirator

- **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale
- |
- **Data e hapjes:** 07-02-2020 Ora : 08:00
- |
- **Data e mbylljes:** 24-03-2020 Ora : 10:00
- |
- **Numri i referencës:** REF-49328-02-05-2020

- Me lote: *Po*
- Anulluar: *Jo*
- Pezulluar: *Jo*

- B. Njoftimi i kontrates së lidhur, referuar nenit 25 të VKM nr.914, Viti 2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit publik”, të ndryshuar permban detyrimisht:
- nr e references se procedures/kontratës dhe emrin e autoritetit kontraktor;
 - pershkrimin e punës/mallrave/sherbimeve. çmimin, kohëzgjatjen e kontratës;)pra objektin, vlerën e kontraktuar, kohën që është në fuqi kontrata).
 - të dhëna të tjera nga autoriteti kontraktor.
- I cili dërgohet për publikim pranë MSHMS (OQB) brenda datës 3 Janar të vitit në vijim në formë të shkruar edhe elektronike)*
- C. - Për sa i përket nje kopje të kontratave të lidhura, sipas autorizimit Nr.457/72 datë 08.06.2020 Marrëveshje Kuadër 24 muaj të ardhur nga M.SH.M.S, për furnizim me oksigjen medical, po j’ua bashkangjisim kësaj shkrese.

Ju faleminderit.

DREJTOR

Genci HYSKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
SPITALI OBSTETRIK GJINEKOLOGJIK KOÇO GLIOZHENI

Nr. 43 Prot

Tirane, më 14/04/2021

KONTRATE PUBLIKE PER FURNIZIMIN E MALIRAVE

**B1 "Blerje barna anti-infektive te përgjithshëm dhe barna antiturbekulare LOT 42
OXYGEN i lengshem mjeksor**

E lidhur sot ne dt. 14/04/2021, mbeshitetur ne vullnetin e lire te paleve, bazuar ne dispozitat e Kodit Civil ligjet e tjera ne fuqi qe rregullojne mardheniet kontraktore, ne Ligjin nr.9643 dt.20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" (i ndryshuar me ligjin 187/2014), ne VKM Nr.914, datë 29.12.2014 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar, duke u bazuar ne marreveshjem kuader Nr. 457/46 prot, ne date 29/04/2020 dhe Autorizimit Nr.457/47 Prot, date 29/04/2020 midis Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale tani e tutje te referuar si Autoriteti Kontraktor (OQB) dhe Operatoreve Ekonomike pale ne kete marreveshje kuader, sipas kushteve te meposhtme:

KREU I: KUSHTET E VEÇANTA (Mallra)

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Ne rast konflikti, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 1: Përkufizime

Autoriteti Kontraktor është – S.U.OGJ Koço Gliozheni, perfaqesuar nga Z.N.Drejtori Ekonomik Anita GUSHO, njohur me poshte si "AUTORITETI KONTRAKTOR" (Bleresi Publik)

Kontraktuesi eshte – "GTS sh.p.k @ MESSER ALBAGAZ" sh.p.k, i quajtur me poshte "Kontraktuesi", perfaqesuar nga Z. per Operatorin Ekonomik – "GTS sh.p.k me NIPT J 61905015 B @ MESSER ALBAGAZ" sh.p.k me NIPT K78317002 F

Neni 2: Objekti i kontrates dhe sasia e mallit

Kontraktuesi mbi bazën e dokumenteve qe disponon pas fitimit të procedures se prokurimit me mjete elektronike: date 27/04/2020, zhvilluar nga Ministria e Shendetesise ne cilesine e organit qendror bleres, do te kryerje furnizimin e mallit për objektin LOT42 OXYGEN i lengshem mjeksor

Shoqeria do te furnizojë dhe faturorje artikujt e specifikuar ne aneksin te kontrates.

Neni 3 Çmimi dhe Vlera

1.Sasia totale e pritshme që "Blerësi" do të blejë nga "Furnizuesi" për periudhën nga data e nënshkrimit deri ne perfundim te kontrates me objekt te kësaj kontrate eshte si vijon: Blerje barna anti-infektive te përgjithshëm dhe barna antiturbekulare B LOT 42 OXYGEN i lengshem mjeksor



2. Vlefia totale e Kontrates per 50% e pare eshte **125000 litra x 135.4 leke = 16.925.000 LEKE**

Neni 4. Afatet e Zbatimit të Kontratës

Afati i zbatimit te kesaj kontrate do te jete nga nga lidhja e kontrates deri ne datë

1401,2022

Bleresi nuk mund te kerkojë reduktimin e afatit te kontrates per asnjë shkak..

Neni 5: Praktikët e Korrupsuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbalëve

Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.

Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogarinë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të komiteteve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 6: Informacioni Konfidencial

Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

Neni 7: Detyrimet e Palëve

"Furnizuesi":

-Të furnizojë "Blerësin" me oksigjen mjekësor të cilësisë së kërkuar dokumentat e tenderit. Mban përgjegjësi për respektimin e standartit të mallit në të gjithë njerin e përcaktuar në ofertën e tij.

-Malli i furnizuar do të shqyrohet me fature tatimore të shitjes.

-Furnizimi do të bëhet në prezencë të grupit të marrjes në dorëzim të mallit.

"Bleresi" :

-Detyrohet të kryejë në kohë pagesat.

-Bleresi me lidhjen e kesaj kontrate dhe me marrjen e dorëzimit të mallit do të bëjë likuidimin e mallit.

-Te lajmëroje 3 (tre) dite para per furnizimin e radhes "Furnizuesin".

Neni 8: Pershtatshmeria e Mallrave me Standartet Teknike

Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standarteve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standartet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktues.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozitë tjetër të kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standart Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike ndërkombëtare të tanishme. Nëse nuk ekzistojnë Standarte Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike përkatëse Shqiptare.

Kontraktuesi nuk do të jetë përgjegjës për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktues me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.

Shitesi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të pronës (Mallrave) për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqsimin e reklames së shitesit (Kontraktuesit).

Neni 9: Ambalazhimi

Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallin sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, malli të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe pakëtuar në pajtim me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe pakëtuar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

Neni 10: Kushtet e Dorëzimit


Kontraktuesi është i detyruar të kryejë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorëzimit me përjashtim kur Kontraktuesi përjashtohet në mënyrë specifike nga një aktivitet ose veprim i tillë nga ndonjë dispozitë e kontratës.

Vendi i dorëzimit të Mallrave do të jetë në prancë institucionit.

Koha e dorëzimit të Mallit dhe data e përfundimit të Shërbimeve në Lidhje me to do të jetë sipas specifikimit në kontratë.

Dorëzimi i Mallrave duhet të bëhet gjatë orarit të punës me përjashtim kur kjo kërkesë bie ndesh me ndonjë dispozitë të kontratës.

Kontraktuesi është i detyruar të japi Autoriteti Kontraktor njoftim të arsyeshëm për dorëzimin e Mallrave përpara arritjes së tyre.



Neni 11: Transportimi i Mallrave

Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë ngarkimin dhe transportimin e Mallrave siç kërkohet me qëllim që të plotësojë afatet dhe kushtet e dorëzimit të specifikuar në kontratë.

Nëse Autoriteti Kontraktor është i detyruar të marrë Mallrat nga ndonjë mjete transporti apo agjenci transporti. Kontraktuesi duhet të japë lajmërim paraprak të arsyeshëm për transportin dhe t'i japë Entit prokurues të gjitha dokumentat e nevojshme për marrjen e Mallrave.

Nëse shitësi, [Kontraktuesi] është i detyruar t'i dorëzojë mallrat në mjedinë e transportit në një vend të specifikuar në kontratë, risiku i humbjes kalon tek Autoriteti Kontraktor vetëm kur mallrat i dorëzohen mjedit të transportit në vendin e specifikuar. Fakti se shitësi [Kontraktuesi] është i autorizuar të mbajë dokumentat përfaqësues të mallrave nuk influencën në kalimin e riskut.

Neni 12: Sigurimi

Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, Kontraktuesi duhet të sigurojë se Mallrat që do dorëzohen sipas kontratës janë plotësisht të siguruar nga humbjes ose dëmtimi gjatë transportit, magazinimit ose dorëzimit të tyre.

Neni 13: Ekzaminimi dhe Pranimi i Mallrave

Përpara pranimi, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të egzaminojë, inspektojë dhe testojë Mallrat. Ky aktivitet duhet të bëhet menjëherë pas dorëzimit të Mallrave. Kontraktuesi ka të drejtë të marrë pjesë në këtë aktivitet dhe të shqyrtojë raportet e aktivitetit të pregatitura nga Autoriteti Kontraktor ose agjentët e tij.

Autoriteti Kontraktor duhet të pranojë ose refuzojë Mallrat menjëherë pas dorëzimit dhe duhet t'i japë Kontraktuesit njoftim me shkrim për veprimin e tij për të pranuar ose refuzuar Mallrat.

Neni 14: Garancitë

Shitësi (Kontraktuesi) mban përgjegjësi për çdo defekt ose mospërputhje që ekziston në momentin kur risiku kalon tek Autoriteti Kontraktor, edhe kur defekti shfaqet pas këtij momenti.

Shitësi (Kontraktuesi) mban përgjegjësi për mospërputhjen që verifikohet pas momentit të treguar në paragrafin e mësipërm dhe që vjen nga mospërmbyllja e ndonjë detyrimi, duke përfshirë garancinë që Mallrat duhet të jenë të përshatshme për përdorimin e tyre të zakonshëm dhe specifik për një periudhë të caktuar kohe, ose se ato do të ruajnë cilësinë dhe karakteristikat e caktuara.

Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë ose nga ligji, Autoriteti Kontraktor humbet të drejtën e tij për të kundërshtuar për të metat e sendit nëse ai nuk i denoncon ato të shitësi (Kontraktuesi), duke specifikuar mënyrën e tyre, brenda dhjetë ditësh nga zbulimi i tyre.



Autoriteti Kontraktor duhet t'i sigurojë Kontraktuesit të gjitha mundësitë e arsyeshme për Kontraktuesin për të inspektuar këto defekte.

Pas marrjes së këtij njoftimi, Kontraktuesi duhet të riparojë menjëherë ose të zëvendësojë Mallrat defektive ose pjesët e tyre gratis për Autoritetin Kontraktor.

Në se pas marrjes së njoftimit, Kontraktuesi dështon në rregullimin e defektit brenda një periudhe të arsyeshme, Autoriteti Kontraktor mund të procedojë me shpërzimet e Kontraktuesit të ndërmarrë veprime për rregullimin e nevojshët.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor humbet të drejtën për të kundërshtuar për ta metat e sendit në se ai nuk e ushtron të drejtën e tij brenda dy vjetësh nga data kur sendet i janë dorëzuar atij, po që se ky afat nuk bën në kundërshtim me kohezgjatjen e garancisë kontraktore.

Shitësi (Kontraktuesi) nuk mund të shfrytëzojë rregullat e parashikuara këtu në se defektet kanë të bëjnë me fakte të njohura prej tij ose që nuk mund të ishin të panjohura për të dhe që nuk i janë vënë në dukje Autoritetit Kontraktor.

Neni 15: Çmimi i Kontratës

Çmimi i kontratës është çmimi i ofruar në ofertën e Kontraktuesit dhe i paguar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 16: Afatet e Pagesës

Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të pagohet në kohë siç specifikohet në kontratë.


Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqiperise i fiksuar në ditën e dërgimit për botimin të njoftimit të kontratës.

Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoritetit Kontraktor me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan Mallrat e dorëzuara dhe shërbimet e kryera.

Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për Vallrat e të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë pranuar Mallrat ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më vonë.

Data e pagesës do të jetë dita që fondei xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor. Pagesa e vlefes së kësaj Kontrate do të bëhet në lek. Menyra e pageses do të jetë me likuidim në llogarine e Bankes Intesa SanPaolo. Monedha e pageses do të jetë LEK. Shqiptar.

Në rast se Bleresi vonon pagesën e mallit, atëherë ai detyrohet t'i paguajë Kontraktuesit penalitetin prej 0.01% të vlefes së pageses për çdo ditë vonese.



Neni 17: Vonesa në Bërçën e Pagesës

Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor, megjithëse kontraktuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij të përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara të detyrimeve kontraktore e tregtare".

Neni 18: Nryshimi i Ligjëve dhe Rregulloreve

Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 19: Forca Madhore

Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuiduara ose ndërprerjen për mospërfundim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhinin dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmyçja, tërmet, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 20: Likuidimi i Dëmtimeve për Dorëzimin e Vonuar

Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore::

Tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 21: Negociatat dhe Amendamentet

Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte njafueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.



Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën e të cilën ajo lëshohet.

Neni 22: Ndryshimi i Porosisë

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Mallra ose Shërbimeve shtesë deri në një masë që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ujgjin mbi Prokurimin Publik.

Neni 23: Ndërprerja për Mosplotësim

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse Kontraktuesi dështon në dorëzimin e Mallrave brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose, Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 24: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 25: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

Autoriteti kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Mallrat e paraqitura dhe Shërbimet në Lidhje me to të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesëve të Mallrave dhe Shërbimeve në Lidhje me to. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesit do t'i kërkohej të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 26: Transferimi i Drejtave

Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e kësaj sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

Neni 27: Sigurimi i Kontrates



Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën 10%

Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Garancia e sigurimit të kontratës do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së pranimit të Mallrave. Megjithatë, pesë (5) përqind e depozitës do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të kontratës.

Neni 28: Baza Ligjore

Baza Ligjore: nenet 772-783, Neni 705 e vijues i Kodit Civil, i ndryshuar; Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar; VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, e ndryshuar.

Neni 29: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhja mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së mosmarrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 30: Përfaqsimi i Palëve

Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.

Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përtipër çdo humbje të sinkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta, rast në të cilin njoftimi me shkrim duhet të dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 31: Lajmërimet

Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetër sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e institucionit.

Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 32: Përshtatshmëria e Mallrave me Standartet Teknike



Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standarteve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet perkatese ose në Standartet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktues.

Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike ndërkombëtare të tanishme. Nëse nuk egzistojnë Standarte Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike perkatese Shqiptare.

Të Fundit

- Kjo kontrate hyn në fuqi me firmosjen e saj prej palëve dhe përfundor në afatit të përcaktuar në nenin 11 të saj.
- Çdo ndryshim në kushtet e kësaj kontrate do të bëhet vetëm me shkrim dhe vetëm me aprovimin (nënshkrimin) e të dy palëve.
- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve do të bëhet me mirëkuptim, në rast të kundërt palët e mësipërme do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Nese ndodh ndonje situatë e Forces Mdhore, "Furnizuesi" duhet te pjojte menjehere Bleresin.

Kjo kontrate u hartua ne 4 (kater) kopje dhe pasi u nenshkrua nga secila palë mbahet 1 (nje) kopje.

KONTRAKTUESI

MESSER ALBAGAZ"shpk
Administrator
Vladimir VLADIMIROV



AUTORITETI KONTRAKTOR

S.O.O.GJ "Këco Gllazheni"
DREKTOR
Genci HYSKA



Aneks Kontrate

Artikulli	Specifikime	Njesia	Cmim/njesi 2020	50% i dyte 2021	Vlera Totale pa TVSH
lot 42- OXYGEN i lengshem injektor	Gaz per perdorim injektor, i lengshem x 100%.	litra	135.4	125000	16.925.000
TOTAL					16.935.000

KONTRAKTUESI

MESSER ALBAGAZ"shpk
Administrator

Vladimir VLADIMIROV



AUTORITETI KONTRAKTOR

S.U.OGJ "Kocë Gliozheni"
DREJTOR

Genç HYSKA





REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
SPITALI OBSTETRIK GJINEKOLOGJIK KOÇO GLIOZHENI

Nr. 214/Prot

Tirane, më 27.04.2020

KONTRATE PUBLIKE PER FURNIZIMIN E MALLRAVE

**B1 "Blerje barna anti-infektive te përgjithshëm dhe barna antiturbekulare LOT 42
OXYGEN i lëshem mjeksor**

E lidhur sot ne dt. 27.04.2020, mbështetur ne vullnetin e ligjit te palëve, bazuar ne dispozitat e Kodit Civil ligjet e tjera ne fuqi qe rregullojne mardheniet kontraktore, ne Ligjin nr.9643 dt.20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" (i ndryshuar me titullin 182/2014), ne VKM Nr.914, date 29.12.2014 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar duke u bazuar ne marreveshjen kuader Nr. 457/46 prot, ne date 29.04/2020 dhe Autorizimit Nr.457/47 Prot, date 29/04/2020 midis Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale tani e tutje te referuar si Autoriteti Kontraktor (OQB) dhe Operatoreve Ekonomike pale ne kete marreveshje kuader, sipas kushteve te mëposhtme:

KREU I: KUSHTET E VEÇANTA (Mallra)

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Ne rast konflikti, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 1: Përkufizime

Autoriteti Kontraktor është – S.U.OGJ Koço Gliozheni, përfaqësuar nga Zv.Drejtori Ekonomik Anita GUSHO, njohur me poshte si "AUTORITETI KONTRAKTOR" (Bleresi Publik)

Kontraktuesi është – "GTS sh.p.k @ MESSER ALBAGAZ" sh.p.k, i quajtur ne poshte "Kontraktuesi", përfaqësuar nga Z. per Operatorin Ekonomik "MESSER ALBAGAZ" sh.p.k me NIPT K78317002 F përfaqësuar nga Administratori Vladimir Vladimirov

Neni 2: Objekti i kontrates dhe sasia e mallit

Kontraktuesi mbi bazën e dokumenteve qe disponon pas fitimit te procedures se prokurimit me mjete elektronike: date 27/04/2020, zhvilluar nga Ministria e Shendetesise ne cilesine e organit qendror bleres, do te kryerje furnizimin e mallit për objektin LOT42 OXYGEN i lëshem mjeksor

Shoqeria do te furnizojë dhe faturojë artikujt e specifikuar ne aneksin te kontrates

Neni 3 Çmimi dhe Vlera

1.Sasia totale e pritshme që "Blerësi" do të blejë nga "Furnizuesi" për periudhën nga data e nënshkrimit deri ne perfundim te kontrates me objekt të kësaj kontra e është si vijon: Blerje barna anti-infektive te përgjithshëm dhe barna antiturbekulare B 1 LOT 42 OXYGEN i lëshem mjeksor



2. Vlefia totale e Kontrates per 50% e pare eshte 125 000 litra x 135.4 leke = 16.925.000 LEKE

Neni 4. Afatet e Zbatimit të Kontratës

Afati i zbatimit te kesaj kontrate do te jete nga nga lidhja e kontrates deri ne datë 31.12.2020

Bleresi nuk mund te kerkojë reduktimin e afatit te kontrates per asnjë shkak.

Neni 5: Praktikave të Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të rrahme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.

Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontabiltëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 6: Informacioni Konfidencial

Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.


Neni 7: Detyrimet e Palëve

"Furnizuesi":

- Të furnizojë "Blerësin" me oksigjen mjekësor të cilësisë së kërkuar dokumentat e tenderit. Mban përgjegjësi për respektimin e standartit të mallit në të gjithë objektin e përcaktuar në ofertën e tij.
- Malli i furnizuar do të shqerohet me fature tatimore të shijes.
- Furnizimi do të bëhet në prezencë të grupit të marrjes në dorëzim të mallit.
- "Furnitori" merr përsipër të mbulojë pa pagesë fuqinë punëtoje të nevojshme për gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të Kontrates.

"Bleresi " :

- Detyrohet të kryejë në kohë pagesat.
- Bleresi me lidhjen e kesaj kontrate dhe me marrjen e dorëzimit të mallit do të bëjë likuidimin e mallit.
- Te lajmëroje 3 (tre) dite para për furnizimin e rrathes "Furnizuesin"



Neni 8: Pershtatshmeria e Mallrave me Standartet Teknike

Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standarteve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, konstatohet ndryshime në kodet perkatese ose ne Standartet Teknike, këto ndryshime do të raportohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktues.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër të kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standart Teknik perkates në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike ndërkombëtare të tanishme. Nëse nuk ekzistojnë Standarte Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike perkatese Shqiptare.

Kontraktuesi nuk do të jetë përgjegjës për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktues me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe kështu: Autoritetin Kontraktor për të.

Shitesi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të prones (Mallrave) për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqsimin e reklamës së shitesit (Kontraktuesit).

Neni 9: Ambalazhimi

Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallin sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe paketuar në pajtim me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe paketuar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

Neni 10: Kushtet e Dorëzimit

Kontraktuesi është i detyruar të kryejë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorëzimit me përjashtim kur Kontraktuesi përjashtohet në mënyrë specifike nga një aktivitet ose veprim i tillë nga ndonjë dispozite e kontratës.

Vendi i dorëzimit të Mallrave do të jetë në prane institucionit.

Koha e dorëzimit të Mallit dhe data e përfundimit të Shërbimeve në lidhje me to do të jetë sipas specifikimit në kontratë.

Dorëzimi i Mallrave duhet të bëhet gjatë orarit të punës me përjashtim kur kjo kërkesë bie ndesh me ndonjë dispozite të kontratës.

Kontraktuesi është i detyruar t'i japë Autoriteti Kontraktor njoftim të arsyeshëm për dorëzimin e Mallrave përpara arrijtes së tyre.



Neni 11 Transportimi i Mallrave

Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë ngarkimin dhe transportimin e Mallrave sipas kërkesës me qëllim që të plotësojë afatet dhe kushtet e dorëzimit të specifikuar në kontratë.

Nëse Autoriteti kontraktor është i detyruar të marrë Mallrat nga ndonjë mjete transporti apo agjenci transporti, Kontraktuesi duhet të japë lajmërim paraprak të arsyeshëm për transportin dhe t'i japë Entit prokurues të gjitha dokumentat e nevojshme për marrjen e Mallrave.

Nëse shitësi, [Kontraktuesi] është i detyruar t'i dorëzojë mallrat në mjetin e transportit në një vend të specifikuar në kontratë, risku i humbjes kalon tek Autoriteti Kontraktor vetëm kur mallrat i dorëzohen mjetit të transportit në vendin e specifikuar. Fakti se shitësi [Kontraktuesi] është i autorizuar të mbajë dokumentat përfunduese të mallrave nuk influencën në kalimin e riskut.

Neni 12: Siguracioni

Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, Kontraktuesi duhet të sigurojë se Mallrat që do dorëzohen sipas kontratës janë plotësisht të siguruar ndaj humbjes ose dëmtimit gjatë transportit, magazinimit ose dorëzimit të tyre.

Neni 13: Ekzaminimi dhe Pranimi i Mallrave

Përpara pranimin, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të egzaminojë, inspektojë dhe testojë Mallrat. Ky aktivitet duhet të bëhet menjëherë pas dorëzimit të Mallrave. Kontraktuesi ka të drejtë të marrë pjesë në këtë aktivitet dhe të shqyrtojë raportet e aktivitetit të pregatitura nga Autoriteti Kontraktor ose agjentët e tij.

Autoriteti Kontraktor duhet të pranojë ose refuzojë Mallrat menjëherë pas dorëzimit dhe duhet t'i japë Kontraktuesit njoftim me shkrim për veprimin e tij për të pranuar ose refuzuar Mallrat.

Neni 14: Garancitë

Shitësi (Kontraktuesi) mban përgjegjësi për çdo defekt ose mospërputhje që ekziston në momentin kur risku kaloi tek Autoriteti Kontraktor, edhe kur defekti shfaqet pas kësaj momenti.

Shitësi (Kontraktuesi) mban përgjegjësi për mospërputhjen që verifikohet pas momentit të treguar në paragrafin e mësipërm dhe që vjen nga mospërmbushja e ndonjë detyrimi, duke përfshirë garancinë që Mallrat duhet të jenë të përshtatshme për përdorimin e tyre të zakonshëm dhe specifik për një periudhë të caktuar kohe, ose se ato do të ruajnë cilësitë dhe karakteristikat e caktuara.

Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë ose nga ligji, Autoriteti Kontraktor humbet të drejtën e tij për të kundërshtuar për të metat e sendit nëse ai nuk i denoncon ato të shitësi (Kontraktuesi), duke specifikuar metat e tyre, brenda dhjetë ditësh nga zbulimi i tyre.



Autoriteti Kontraktor duhet t'i sigurojë Kontraktuesit të gjitha mandësitë e arsyeshme për Kontraktuesin për të inspektuar këto defekte.

Pas marrjes së këtij njoftimi, Kontraktuesi duhet të riparojë menjëherë ose të zëvendësojë Mallrat defektive ose pjesët e tyre gratis për Autoritetin Kontraktor.

Në se pas marrjes së njoftimit, Kontraktuesi dështon në rregullimin e defektit brenda një periudhe të arsyeshme, Autoriteti Kontraktor mund të procedojë, me shpenzimet e Kontraktuesit, të ndërparre veprime për rregullimin e nevojshëm.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor humbet të drejtën për të kundërshtuar për të metat e sendit në se ai nuk e ushtron të drejtën e tij brenda dy vjetësh nga data kur sendet i janë dorëzuar atij, po që se ky afat nuk bie në kundërshtim me kohëzgjatjen e garancisë kontraktore.

Shitësi (Kontraktuesi) nuk mund të shfrytëzojë rregullat e parashikuara këtu në se defektet kanë të bëjnë me fakte të njohura prej tij ose që nuk mund të ishin të parijohura për të dhe që nuk i janë vënë në dukje Autoritetit Kontraktor.

Neni 15: Çmimi i Kontratës

Çmimi i kontratës është çmimi i ofruar në ofertën e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 16: Afatet e Pagesës

Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.

Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqiperise i fiksuar në ditën e dërgimit për botimin të njoftimit të kontratës.

Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoritetit Kontraktor me shkëmbim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan Mallrat e dorëzuara dhe shërbimet e kryera.

Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për Mallrat do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë pranuar Mallrat ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më vonë.

Data e pagesës do të jetë dita që fonder xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor. Pagesa e vlefes së kësaj Kontrate do të bëhet në lek. Menyra e pageses do të jetë në likuidim në llogarinë e Bankes Intesa SanPaolo. Monedha e pageses do të jetë LIRE Shqiptar.

Në rast se Bleresi vonon pagesën e mallit, atëherë ai detyrohet t'i paguajë Kontraktuesit penaltetin prej 0.01% të vlefes së pageses për çdo ditë vonese.



Neni 17: Vonesa në Bërjen e Pagesës

Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor, megjithëse kontraktuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetara dhe kamatëvonesa përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

Neni 18: Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet e çmimit të kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 19: Forca Madhore

Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të Kontrates, dëmeve të likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor sofië në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufra ose revolucionet, zjarri, përmbysja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 20: Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:

Tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 21: Negociatat dhe Amendamentet

Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte njafueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.



Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën 10%

Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Garancia e sigurimit të kontratës do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së pranimit të Mallrave. Megjithatë, pesë (5) përqind e depozitës do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të kontratës.

Neni 28: Baza Ligjore

Baza Ligjore: , nenet 772-783, Neni 705 e vijues i Kodit Civil, i ndryshuar; Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar; VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, e ndryshuar.

Neni 29: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së mosmarrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 30: Përfaqsimi i Palëve

Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.

Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të menjpërdhoshëm.

Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta, rast në të cilin njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 31: Lajmërimet

Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetres sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e institucionit.

Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 32 : Pershtatshmeria e Mallrave me Standartet Teknikel



Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standarteve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet perkatese ose ne Standartet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktues.

Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike ndërkombëtare të tatishme. Nëse nuk ekzistojnë Standarte Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike perkatese Shqiptare.

Të Fundit

- Kjo kontrate hyn në fuqi me firmosjen e saj prej paleve dhe përfundon në afatit e përcaktuar në nenin 11 të saj.
- Çdo ndryshim në kushtet e kësaj kontrate do të bëhet vetëm me shkrim dhe vetëm me aprovimin (nënshkrimin) e të dy palëve.
- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve do të bëhet me mirëkuptim, në rast të kundërt palët e mësipërme do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Nese ndodh ndonje situatë e Forcës Madhore, "Furnizuesi" duhet të sjellë menjëherë Blerësin.

Kjo kontrate u hartua në 4 (kater) kopje dhe pasi u nënshkrua nga secila palë mbahet 1 (nje) kopje.

Aneks Kontrate

Artikulli	Specifikime	Njesia	Cnim/njesi 2020	50% i pare 2020	Vlera Totale pa IVSH
Lot 42- OXYGEN i lengshem mjeksor	Gaz per perdorim mjeksor, i lengshem x 100%	litra	135.4	125000	16.924.000
TOTAL					16.934.000

KONTRAKTUESI

MESSER ALBAGAZ"shpk
Administrator
Vladimir Vladimirov

AUTORITETI KONTRAKTOR

S.U.O.G.I "Kënga Glinzhoni"
Zv. Drejtor Ekzekutiv

Angela GUSHO



[Handwritten signature]